



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 21.4 dhe 43.1 të Rregullorës për Prokurimit Publik

Titulli i kontratës:

“HAPJA E PUSIT NË OBJEKTIN E RI TË QKMF-s NË MAMUSHË-RITENDER 3”

Numri i aktivitetit të prokurimit:

Nr i prokurimit	626-23-9528-5-2-1
Nr i brendshëm	626-23-010-5-2-1

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave
1.	Grupi i Operatorëve Ekonomik-VAHID MAZREK B.I&GASHI ING SHPK, MAMUSHË, 20540, MAMUSHË	14,935.00 €
2.	Grupi i Operatorëve Ekonomik- Geo Grup Ing SHPK, Dua ARCH SHPK, Krushë e Vogël, 20000, Prizren	14,970.00 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna e Mamushës - Zyra e Prokurimit shpërblen me kontratë Grupin e operatorëve ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët “VAHID MAZREK B.I&GASHI ING SHPK”, Mamushë në vlerë totale të ofertës prej 14,935.00 €.

Data: 29.09.2023

Emri dhe mbiemri i ZPP: Gazmend Gashi

Nënshkrimi: _____

Këshillë juridike: Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga vendimi i autoritetit kontraktues gjatë kryerjes së këtij aktiviteti të prokurimit, mund të bëjë kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e Autoritetit Kontraktues, përmes platformës elektronike.

¹Ketij formulari I bashkangjiten edhe letrat standard të njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoniletrannjoftuesesipasnevojës).



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm²

Mamushë më: 29.09.2023

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit

Për: Grupi i Operatoreve Ekonomik-VAHID MAZREK B.I&GASHI ING SHPK, MAMUSHË, 20540, MAMUSHË

Nr i prokurimit	626-23-9528-5-2-1
Nr i brendshëm	626-23-010-5-2-1

Titulli: “HAPJA E PUSIT NË OBJEKTIN E RI TË QKMF-s NË MAMUSHË-RITENDER 3”

I nderuar Z. VAHID MAZREK

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, si përgjigje ndaj kërkesës për tenderin në lidhje me aktivitetin e prokurimit të lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit të intervalit, gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.

Bashkëngjitur me këtë letër është vendimi për dhënie të kontratës

Me respekt,

Gazmend Gashi

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit


Nënshkrimi

² Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar³

Mamushë më: 29.09.2023

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit

Për: Operatorin Ekonomik: - Grupi i Operatorve Ekonomik- Geo Grup Ing SHPK, Dua ARCH SHPK,
Krushë e Vogël, 20000, Prizren

Nr i prokurimit	626-23-9528-5-2-1
Nr i brendshëm	626-23-010-5-2-1

Titulli: “HAPJA E PUSIT NË OBJEKTIN E RI TË QKMF-s NË MAMUSHË-RITENDER 3”

I nderuar Z. JETMIR MUSTAFA

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP”.

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

Nuk e keni dorëzuar:

☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara të cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;

☐ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme të kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;

☒ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe të kapacitetit teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

Tenderi i juaj është administrativisht i papërgjegjshëm:

☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet [Formularin e paraqitjes së tenderit]

³ Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë të pa përgjegjshëm dhe të parregullt.

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
- ☐ Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant të prokurimit;
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat formale/administrative
- ☒ Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

☒ **Nuk i keni paraqitur dëshmitë e kërkuara për mjetet dhe pajisjet teknike për realizimin e kontratës.**

☐ Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative

[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]-N/A

☐ Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

Në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek Seksioni II. Fleta e të dhënave të tenderit (FDT) në neni 9.1 & 9.2 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar si më poshtë:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte të ngjashme gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimumi 20,000.00 € (njëzetmijë euro).

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Lista e projekteve të realizuara për punë të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë punët e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me "Referencë" ose "Raport" për realizimin me sukses të Kontratës. (i) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës (transaksioni bankar fatura etj).

Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të tenderit në fjalë, konkretisht ofertës tuaj, ka konstatuar që ju si O.E keni dorëzuar listën e kontratave(projekteve) , por nuk keni dorëzuar (Referencë ose Raport) si dëshmi për projektet e realizuara, sikur i keni paraqitur në listën e kontratave(projekteve).

Me datën 20.09.2023 ju është bërë kërkesa me Letër standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit B47, ku është kërkuar që deri më dt.22.09.2023 ora 14:00 të na ktheni përgjigje dhe nëse i posedoni dokumentet të njëjtat të na dërgoni përmes platformës së e- prokurimit.

Pas përgjigjes së kërkesës tonë, ju keni dorëzuar referencës dhe transaksionet, mirëpo nga të njëjtat shihet se vlera e projekteve të realizuara është 18,205.73 euro dhe jo 22.550.00 euro sikur keni cekur në listën e projekteve. Andaj komisioni ka konstatuar që nuk e keni plotësuar kërkesën e lartcekur.

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Gjithashtu në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës në pikën 3 të nenit 9.1 & 9.2 është paraqitur Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale si vijon:

3.OE duhet të posedon makineritë dhe mjetet e punës, të domosdoshme për realizim të projektit, së paku 1(një) Kamion me pesh ngarkuese minimum 10 ton, 1 (një) Eskavator minimum 10 ton, dhe një makinë për shpuarjen e pusit. Të plotësohet, nënshkruhet dhe vuloset aneksi nr. 8.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

3. Lista e makinerisë dhe mjeteve të punës që do të përdoret në realizim të projektit, me dokumentacion të pronësisë (Duhet të kopjohen Certifikatat e Regjistrimit të automjetit (CRA) të mjeteve ose dokumenti unik doganor (DUD) dhe të paraqiten me rastin e tenderimit) ose nëse merren në shfrytëzim (kontrata origjinale për shfrytëzim ose kopja e noterizuar si dhe dëshmitë e pronësisë së dhënësit në shfrytëzim të cekura më lartë).

Ju keni dorëzuar marrëveshje për shfrytëzimin e makinerisë me EUROTRANS SHPK në të cilën nuk keni specifikuar se cilat pajisje i keni marrë në shfrytëzim, andaj me dt 20.09.2023 është bërë kërkesa me Letër standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit B47, ku në të është cekur se cilat pajisje janë marrë me qira pasi në marrëveshje është cekur se furnizuesi është pronar i kompanisë me bazë asfalti dhe pajtohet që ta furnizoj kontraktuesin. Por në përgjigjen tuaj ju nuk keni dhënë kurrfarë sqarimi në lidhje me këtë çështje por keni dorëzuar disa marrëveshje tjera të cilat nuk i keni dorëzuar me tenderin tuaj.

Gjithashtu në dosje të tenderit në nenin 11.1 është paraparë se cilat dokumente duhet të dorëzojnë grupi i operatorëve ekonomik, me ç'rast në pikën b) është paraqitur kërkesa si vijon: një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyrë individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;

Ju keni dorëzuar marrëveshjen e grupit dhe dokumentet e kërkuara në pikat a dhe c mirëpo nuk keni dorëzuar kurrfarë dokumenti sa i përket pikës b)

Lëshimet e cekura më lart kanë bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Gazmend Gashi

Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit


Nënshkrimi